STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 16 nëntor 2012

DEKLARATE NGA GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) MBI SHPALLJEN FEDERALE TE KATASTROFES SE BURIMEVE TE INDUSTRISE SE PESHKIMIT SI REZULTAT I URAGANIT SENDI (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) sot nxorri deklaratën e mëposhtme mbi shpalljen nga Departamenti i Tregtisë të SHBA-së të një katastrofe të burimeve të industrisë së peshkimit për Nju Jorkun si rezultat i shkatërrimit bregdetar të shkaktuar nga Uragani Sendi (Sandy). Deklarata autorizon menjëherë Administratën e Bizneseve të Vogla të SHBA-së që të japë hua për katastrofën për bizneset e peshkimit të prekura dhe të sigurojë një bazë që Kongresi të caktojë ndihmën me financime për katastrofën për komunitetet bregdetare në qarqet Naso (Nassau), Safolk (Suffolk), Uestçester (Westchester), Roklënd (Rockland), Putnëm (Putnam), Oranxh (Orange) dhe Qytetin e Nju Jorkut.

"Uragani Sendi (Sandy) shkaktoi shkatërrim të përhapur gjerë në industrinë e peshkimit përgjatë bregdetit të prekur rëndë të Nju Jorkut," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Kjo shpallje federale do të na lejojë të rindërojmë këtë industri jetësore, e cila shërben si arteria ekonomike për shumë nga komunitetet tona bregdetare."

Shkalla e ndikimit në industrinë e peshkimit në Nju Jork nuk është përllogaritur ende. Informacioni paraprak nga Departamenti i Mbrojtjes Mjedisosore i Nju Jorkut tregon dëm të gjerë të anijeve, dokëve, dyqaneve, uzinave të përpunimit dhe bizneseve ndihmëse, si dhe mbylljen e shumë zonave të peshkimit të molusqeve.

Ligji federal për Ruajtjen dhe Administrimin e Industrisë së Peshkimit Magnuson-Stevens i lejon Departamentit të Tregtisë të SHBA-së që të përcaktojë se ka ndodhur një dëmtim i industrisë tregtare të peshkimit dhe të sigurojë ndihmë ekonomike për industrinë e peshkimit sipas një shpallje të katastrofës. Një dëmtim do të thotë një ngjarje kur ata që janë të përfshirë në industrinë e peshkimit përjetojnë vështirësi të mëdha ekonomike për shkak të një katastrofe të burimeve të industrisë së peshkimit.

"Uragani Sendi (Sandy) kishte një ndikim shkatërrues në infrastrukturën që i nevojitet industrisë së peshkimit," ka Komisioneri i DEC-ës Martens. "Ndikimet afat-gjata do të jenë të mëdha dhe do të jetë e vështirë që industria të rimëkëmbet pa ndihmë. Shpallja e katastrofës është hapi i parë në ndihmën për të rindërtuar dokët jetësorë, zonat e ankorimit dhe infrastrukturën tjetër që ndihmon industrinë."

Industria e peshkimit, përfshirë flotat tregtare dhe me qira të peshkimit, shpërndarësit dhe përpunuesit, komunitetin e peshkimit të molusqeve dhe infrastrukturën e peshkimit tani do të kenë të drejtë të marrin hua federale dhe kompensim për dëme që përndryshe nuk do të mbuloheshin nga policat ekzistuese të sigurimit. Ndikimet në mjediset e bashkive, si rrafshet e pjerrët të anijeve, dokët dhe molet e peshkimit gjithashtu do të kualifikohen.

Hollësi mbi programin e huave të Administrimit të Bizneseve të Vogla menjeherë të disponueshme janë në dispozicion në http://www.sba.gov/community/blogs/official-sba-news-and-views/open-business/hurricane-sandy-update-2-sba-standing-read.

Departamenti i Tregtisë gjithashtu do t'a përdorë këtë shpallje për t'i kërkuar Kongresit që të caktojë fonde shtesë për katastrofën për të ndihmuar më tej komunitetin e peshkimit. Meqë shkatërrimi i shkaktuar nga Uragani Sendi (Sandy) ndikoi shumë shtete, Departamenti i Tregtisë mund të heqë dorë nga kërkesa që shtetet të mbajnë njëzet e pesë përqind të kostos.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418